



A JANË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME RRUGA E VETME PËR DALJE NGA KRIZA?

FAJE 4



Ka kohë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë marrë vëmendje sikurse këtë vit. Ndoshta se kanë qenë disa, ndoshta se kanë pasur të bëjnë me

politikën, ndoshta se askush nuk e ka ditur cila është rruga përpara për dalje nga kriza institucionale dhe ka tentuar të gjejë ngushëllim në to. Por, këtë herë, duket sikur

situata është më ndryshe, që Kosova nuk ka shpëtimit më nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Po si mund të arrihet deri aty?

**MILIONAT E HUMBUR
NGA KONTRATAT
KOLEKTIVE: KOMUNAT
KËRKOJNË
PËRGJEGJËSI
NGA QEVERIA**

F. 7



**ULUTASH
RIKTHEHET
NË
KOMANDËN
E KFOR-it**

F. 6



AKTUALE



**RUBINI: HAGA TA BËJË GJËNË
E DUHUR, T'I SHPALLË TË
PAFAJSHËM LIDERËT E UÇK-së**

F. 2

**ZELENSKY: EVROPËS I NEVOJITEN
MBROJTJE QË JANË NË GJENDJE
T'U BËJNË BALLË DRONËVE**

F. 2

**NIMANI: MUNGESA E MIRATIMIT TË
BUXHETIT TË VITIT 2026 BRENDA
AFATIT LIGJOR, ALARM SERIOZ
PËR SHTETIN TONË**

F. 7

EKONOMI



**AKB-JA: KOSOVA NË PRAG TË
KOLAPSIT EKONOMIK, RITEN
VARFËRIA DHE TKURRJA
E POPULLSISË**

F. 8

**RESHJET E BORËS NË KOSOVË
SHKAKTOJNË PRISHJE NË RRJETIN
ELEKTRIK SHPËRNDARËS**

F. 8

SPORT



**KOSOVA PUBLIKON LISTËN
E FUTBOLLISTËVE PËR NDESHJET
E TETORIT**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBINI: HAGA TA BËJË GJËNË E DUHUR, T'I SHPALLË TË PAFAJSHËM LIDERËT E UÇK-SË

PRISHTINË, 3 TETOR - Ish-zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, ka deklaruar edhe një herë se ish-presidenti Hashim Thaçi nuk kishte rol kyç në udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Këtë deklaratë Rubin e ka dhënë për gazetaren e njohur, Christiane Amanpour, pas përfundimit të dëshmisë së tij në Hagë. “Nuk është e vërtetë që të gjithë shqiptarët urrejnë serbët, dhe të gjithë serbët urrejnë shqiptarët. Por ky gjyq është duke fajësuar liderët e UÇK-së për gjërat që ata nuk kishin kontroll. Ishte shumë e qartë se zotëri Thaçi, një djalë i ri në atë kohë,

nuk kishte kontroll mbi asgjë”, është shprehur ish-zyrtari amerikan. Gjatë intervistës me Amanpourin, Rubini ka thënë se ishte i befasuar nga gjyqtarët në Hagë gjatë dëshmisë së tij pro ish-presidentit Hashim Thaçi. “Gjyqtarët, për befasinë time, më bënë pyetje që më dukën tepër të anshme. Nuk tingëllonin si pyetje që kërkonin të gjenin fakte. Prokuroria duhet ta shtrojë akuzën e saj. Mbrojtja ta shtrojë mbrojtjen e saj. Gjyqtarët supozohet që thjesht duhet të mbledhin evidencë në mënyrë që ta bëjnë gjykimin më pas. Dhe prej pyetjeve që m'u bënë nga

disa prej gjyqtarëve, m'u duk se tashmë kishin marrë vendim se UÇK-ja ishte tamam organizatë që funksiononte si duhet me Hashim Thaçin në krye, gjë që s'është e vërtetë”, ka thënë Rubini. Sipas tij, Gjykata Speciale duhet të bëjë gjënë e duhur dhe t'i lirojë liderët e UÇK-së. “Ky tribunal duhet të bëjë gjënë e duhur, duhet t'i shpallë ata të pafajshëm, pastaj Shtetet e Bashkuara së bashku me Evropën duhet të ulen me udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë dhe të rregullojnë këtë problem”, ka thënë ai. James Rubini, po ashtu, ka thënë se Ballkani është në një situatë të frikshme, por jo në një zonë lufte.



ZELENSKY: EVROPËS I NEVOJITEN MBROJTJE QË JANË NË GJENDJE T'U BËJNË BALLË DRONËVE

KOPENHAGË, 3 TETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka paralajmëruar të enjten liderët evropianë se Rusia ka aftësinë për ta shkelur hapësirën ajrore kudo në kontinent, prandaj u ka bërë thirrje atyre të zhvillojnë forca mbrojtëse për t'i zmbrapsur dronët. “Nëse rusët guxojnë të lëshojnë dronë kundër Polonisë, ose ta shkelin hapësirën ajrore të vendeve të Evropës veriore, kjo do të thotë se mund të ndodhë kudo”, tha Zelensky para liderëve evropianë të mbledhur në një samit për sigurinë dhe mbrojtjen në Kopenhagë. “Në Evropën Perëndimore, në jug, kemi nevojë për reagim të shpejtë dhe forca mbrojtëse efektive që dinë si të merren me dronët”, shtoi ai. Samiti i Komunitetit Politik Evropian vjen pas shfaqjes së dronëve në Danimarkë, që detyruan mbylljen e aeroportit të Kopenhagës më 22 shtator, si dhe pas disa shkeljeve të hapësirës ajrore të vendeve evropiane nga dronët rusë. Kryeministrja e Danimarkës,



Mette Frederiksen, e cila është mikpritëse e takimit, tha se Ukraina është eksperti më i madh në botë për mbrojtjen kundër dronëve, dhe i këshilloi vendet e tjera evropiane “t'i marrin të gjitha përvojat, teknologjinë e re dhe risitë nga Ukraina dhe t'i vendosin në procesin tonë të riarmatimit”. Kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Store, vendi i të cilit ka përjetuar kohët e fundit incidente me dronë që penguan trafikun ajror, tha se vendet evropiane po nxjerrin “mësime shumë të vështira” nga përvoja e Ukrainës në përballjen me dronët rusë.

“Duhet ta përmirësojmë kapacitetin tonë të zbulimit. Duhet ta forcojmë bashkëpunimin mes policisë dhe ushtrisë, dhe po punojmë për këtë”, tha Store. Shefi i NATO-s, Mark Rutte, tha se Ukraina është “fuqi e madhe” në teknologjinë kundër dronëve, dhe shtoi se teknologjitë dhe njohuritë e fituara gjatë luftës po i ndan me Danimarkën, Poloninë dhe NATO-n në përgjithësi. Pak para fillimit të takimit në Kopenhagë, Rusia vazhdoi sulmet mbi fqinjin e saj perëndimor, duke goditur një depo

hekurudhore në Odesa. Oleksiy Kuleba, ministri ukrainas i Zhvillimit Territorial, tha se ky ishte një tjetër shembull i përpjekjeve të Rusisë për të “shkatërruar një nga themelet e qëndrueshmërisë së Ukrainës” duke goditur infrastrukturën. Ai theksoi se sulme me raketa dhe dronë u raportuan edhe në rajonet e Kievit, Dnipropetrovskut dhe Zaporizhjas. Frederiksen e quajti më herët “luftë hibride” shkeljen e hapësirës ajrore nga dronët, duke theksuar se e sheh Ukrainën si “vijën e parë të mbrojtjes”. “Nga një këndvështrim evropian, ka vetëm një vend që është i gatshëm të na kërcënojë. Ajo është Rusia, prandaj kemi nevojë për një përgjigje shumë të fortë”, tha ajo para takimit. Samiti i Kopenhagës zhvillohet në një kohë kur gjasat për paqe duken më të largëta se kurrë, ndërsa pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia po i afrohet vitit të katërt. Ndërkohë që përpjekjet e ShBA-së

për të ndërmjetësuar një marrëveshje paqeje kanë sjellë pak përparim, qëndrimet e Ukrainës dhe Rusisë mbeten shumë të kundërta. Presidenti amerikan Donald Trump deri tani nuk ka arritur të organizojë një samit trepalësh apo një takim ballë për ballë mes presidentit të Rusisë dhe atij të Ukrainës. Dy palët kanë rënë dakord për shkëmbime të herëpashershme të të burgosurve, dhe më 2 tetor u zhvillua një tjetër shkëmbim. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha në “Telegram” se 185 ushtarë rusë ishin kthyer, duke shtuar se 20 civilë u liruan gjithashtu si pjesë e shkëmbimit. Zelensky e konfirmoi shkëmbimin, duke publikuar fotografi të ukrainasve të liruar të mbështjellë me flamuj ukrainas. “Po i sjellim në shtëpi 185 nga mbrojtësit tanë nga robëria ruse. Njëqind e tetëdhjetë e tre janë ushtarë dhe rreshterë, dhe dy janë oficerë”, tha Zelensky në X. Ai shtoi se edhe 20 civilë po kthehen në shtëpi.

RIHAPET AEROPORTI I MUNIHUT PAS DETEKTIMIT TË DRONËVE

MUNIH, 3 TETOR - Në Aeroportin e Munihut në Gjermani kanë rinisur fluturimet më 3 tetor, pasi u detektuan disa dronë që detyruan autoritetet ta mbyllnin aeroportin gjatë natës. Ky është rasti i fundit në një seri mbylljesh të aeroportëve së voni në mbarë Evropën për shkak të fluturimeve të dronëve të paidentifikuar. Aeroportet në Danimarkë, Norvegji dhe Poloni së voni kanë pezulluar fluturime për shkak të dronëve të paidentifikuar, ndërkaq Rumania dhe Estonia kanë fajësuar Rusinë për këto incidente. Moska ka hedhur poshtë akuzat. Më shumë se 30 fluturime u anuluan në Munihi për shkak të

dronëve që u panë mbrëmjen e së enjtes, duke lënë të bllokuar pothuajse tre mijë pasagjerë. Fluturimet rinisën mëngjesin e së premtes dhe, sipas të dhënave të uebfaqeve që gjurmojnë fluturimet, fluturimi i parë nga ky aeroport u realizua në orën 05:50. Një zëdhënës i policisë i ka thënë më herët AFP-së se disa persona panë dronët përreth aeroportit në orën 19:30 të së enjtes dhe sërisht një orë më vonë, duke detyruar autoritetet t'i ndalnin fluturimet. Autoritetet gjermane kanë nisur hetimet për ta identifikuar origjinën e dronëve. Helikopterët e policisë u dislokuan pas detektimit të dronëve, “por nuk ka

informacione se çfarë lloji ishin fluturaket dhe sa ishte numri i tyre”, tha zëdhënësi i policisë. Detektimi i dronëve në Danimarkë dhe inkursioni i Moskës në Estoni dhe Poloni kanë rritur frikën se lufta e Rusisë në Ukrainë mund të zgjerohet edhe në shtete të tjera të Evropës. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky paralajmëroi Evropën të enjten se inkursionet e fundit me dronë tregojnë se Moska po synon ta “përshtatë” agresionin. Gjermania është në gjendje të lartë gatishmërie pasi javën e kaluar tha se detektoi dronë mbi objekte ushtarake dhe industriale. Ministri i Brendshëm, Alexander Dobrindt, ka thënë se Berlini ka



nevojë “të gjejë përgjigje të reja për këtë kërcënim hibrid”, përfshirë edhe rrëzimin potencial të dronëve. Gjatë kësaj jave udhëheqësit e Bashkimit Evropian u takuan në

Kopenhagë për të diskutuar për forcimin e mbrojtjes së bllokut dhe për të krijuar një “mur për dronët”. Rusia ka deklaruar se këto plane të BE-së do ta përshkallëzojnë situatën.

Osmani: Siguria e Evropës është e ndërlidhur ngushtë me sigurinë e Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 3 TETOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë pjesëmarrjes së saj në Samitin e Liderëve të EPC-së në Kopenhagë, në tryezën e diskutimit me liderë evropianë të fokusuar në temën e sigurisë, ka folur për sigurinë e Evropës, e cila, siç tha, “është e ndërlidhur ngushtë me sigurinë e Ballkanit Perëndimor”. “Në Samitin e Liderëve të EPC-së në Kopenhagë, në tryezën me liderë evropianë të fokusuar në

temën e sigurisë, theksova se siguria e Evropës është e ndërlidhur ngushtë me sigurinë e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, Evropa duhet të përqendrojë vëmendjen e saj në këtë rajon, duke investuar në parandalimin e taktikave destabilizuese të Serbisë, si hap kyç për një siguri të qëndrueshme dhe afatgjatë”, ka shkruar Osmani në “Facebook”. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, një ditë para nisjes së

Samitit të liderëve të Komunitetit Politik Evropian (EPC) në Danimarkë ka folur për sigurinë në rajon dhe më gjerë. Ajo theksoi se Serbia historikisht i ka trajtuar fqinjët e saj si shtete joekzistente, si shtete të përkohshme, duke vepruar ndaj tyre me agresion. Osmani theksoi se aktualisht ka dy kërcënime kryesore të sigurisë ndaj vendeve të kontinentit, njëri nga Rusia, tjetri nga Serbia.



KOSOVA ARRESTON NJË SHTETAS TË SERBISË PËR SULM NDAJ POLICËVE NË JARINJË



Prishtinë, 3 tetor - Një shtetas i Serbisë është arrestuar dhe është dërguar në mbajtje policore pasi ka sulmuar zyrtarët policorë në pikën kufitare të Jarinjës, bëri me dije Policia e Kosovës. Ngjarja ka ndodhur më 2 tetor në orën 04:55 dhe një zyrtar policor ka marrë tretman mjekësor, sipas raportit 24-orësh të policisë. Për këtë rast, policia nuk ka dhënë hollësi të tjera. Pika kufitare e Jarinjës gjendet në Leposaviq - një nga katër komunat në veri të Kosovës të

banuara me shumicë serbe - që lidh Kosovën me Serbinë. Përveç Jarinjës, pikat e tjera kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë janë ajo e Bërnjakut, Merdarës, Mutivodës, Dheut të Bardhë dhe Muçibabës. Kosova dhe Serbia ndajnë një vijë kufitare të gjatë rreth 350 kilometra dhe të dyja shtetet zyrtarisht nuk e kanë kryer procesin e demarkacionit të kufirit. Në vitet e fundit në vijën kufitare kanë ndodhur disa incidente. Misioni paqeruajtës i NATO-s

në Kosovë, KFOR, që nga përfundimi i luftës më 1999 përkujdeset për sigurinë e kufijve të Kosovës. Ky mision e ka këtë përgjegjësi bazuar në atë që njihet si Marrëveshje Ushtarako-Teknike e Kumanovës, e cila i ka dhënë fund luftës në Kosovë. Serbia e ka nënshkruar këtë marrëveshje me NATO-n në vitin 1999, duke i tërhequr më pas të gjitha forcat policore dhe ushtarake nga Kosova. Megjithatë, që nga viti 1999 edhe Policia e Kosovës kryen patrullime në vijën kufitare.

KOSOVA SHPREH MBËSHTETJEN E PLOTË PËR THELLIMIN E PARTNERITETIT ME IOWAN

PRISHTINË, 3 TETOR - Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, priti në takim delegacionin e drejtuesve të institucioneve të zbatimit të ligjit nga Iowa që po viziton Kosovën. Ministria Gërvalla e njoftoi delegacionin nga Iowa për përparimin e vazhdueshëm të Kosovës në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit në të gjithë territorin, i konfirmuar edhe nga raportet kredibile ndërkombëtare, të cilat e vendosin Republikën e Kosovës në krye të renditjeve në Evropë dhe në botë sa i takon sigurisë. Duke iu referuar rezultateve konkrete që janë arritur në bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Iowas deri më tani, ministria Gërvalla shprehu mbështetjen e plotë për thellimin dhe zgjerimin e



mëtejshëm të partneritetit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit, si një komponent i rëndësishëm dhe me potencial në këtë aspekt. Ministria Gërvalla theksoi, po ashtu, mirënjohjen e përhershme të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj për mbështetjen e gjithanshme të institucioneve qendrore e lokale, si dhe të miqve të shumtë të Kosovës në Iowa dhe më gjerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke falënderuar për zemërsisht gjeneralmajorin (në pension) Timothy Orr, i cili ishte i pranishëm në takim, për përkushtimin e tij, ministria Gërvalla shprehu mirënjohje të veçantë edhe për Gardën Kombëtare të Iowas për përkrahjen e vazhdueshme në ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Protesta në Tiranë për mbrojtjen e çlirimtarëve, Krasniqi bën thirrje për pjesëmarrje masive

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka bërë thirrje për pjesëmarrje në protestën e organizuar në Tiranë në

përkrahje të kërërve të UÇK-së që po gjykohen në Hagë. “Më 17 tetor, ora 17:00, në sheshin ‘Skënderbeu’ të Tiranës, protestë gjithëkombëtare në mbrojtje të çlirimtarëve tanë

që po mbahen në Hagë. Le të jetë kjo protestë thirrja e të gjithë shqiptarëve, kudo që jetojnë, për të mbrojtur historinë, dinjitetin dhe luftën tonë për liri. Nga Tirana në

Prishtinë, nga Shkupi në Ulqin, nga Presheva deri në diasporë, një zë, një qëndrim, një kauzë: Drejtësi për çlirimtarët tanë!”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.





A JANË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME RRUGA E VETME PËR DALJE NGA KRIZA?

Ka kohë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë marrë vëmendje sikurse këtë vit. Ndoshta se kanë qenë disa, ndoshta se kanë pasur të bëjnë me politikën, ndoshta se askush nuk e ka ditur cila është rruga përpara për dalje nga kriza institucionale dhe ka tentuar të gjejë ngushëllim në to. Por, këtë herë, duket sikur situata është më ndryshe, që Kosova nuk ka shpëtim më nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare. E si mund të arrihet deri aty?

Prishtinë, 3 tetor - Një tjetër muaj, një tjetër vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, një tjetër moment paqartësie. Situata e përsëritur disa herë këtë vit. I vetmi dallim është që partitë më të mëdha shqiptare nuk e komentuan pothuajse fare vendimin e gjykatës, e cila tha se Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar dhe se kanë mbetur edhe 12 ditë për ta finalizuar procesin prej momentit kur aktgjykimi të publikohet i plotë në faqen zyrtare të këtij institucioni. Nëse i analizojmë faqet zyrtare të partive në rrjete sociale, krerët e tyre duken shumë të zënë me fushatën për zgjedhjet lokale të 12 tetorit, apo me takime me zyrtarë të huaj. Por, njohësit e çështjeve politike u sugjerojnë atyre të ruajnë pak energji, sepse me shumë gjasë do t'u duhet për zgjedhje të parakohshme

parlamentare. Sociologu nga Prishtina, Artan Muhaxhiri, beson se nuk ekziston asnjë mundësi tjetër për të dalë nga kriza institucionale në të cilën gjendet vendi. "Nuk ka asnjë logjikë që të vazhdohet me këtë bllokadë. Për fat të keq, e kemi një absurditet, që as Lëvizja Vetëvendosje (LV), si fituese e zgjedhjeve, dhe as partitë tjera, nuk dëshirojnë ta bëjnë shumicën, nuk kanë vullnet, nuk kanë guxim, nuk kanë ide", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë" (REL). "Për këtë arsye, opsioni më i mirë është që të shkohet në zgjedhjet e reja, që të rilegjitimohen partitë politike, liderët, deputetët dhe të tentohet një kthim në normalitet", shprehet Muhaxhiri. Për politologun Dritëro Arifi zgjedhjet nuk janë zgjidhje, por janë mënyra e vetme për t'u larguar nga ajo që ai e quan

"marrëzi politike". "Vendi është, realisht, në anarki, Kosova është në anarki totale. Parlamenti nuk ka kontroll, as mbi Qeverinë, as mbi Policinë, as mbi ushtrinë, as mbi inteligjencën. Realisht është vend pa kontroll", thotë ai për "REL"-in.

Si erdhëm deri këtu?

Ende pa u formuar institucionet e reja nga zgjedhjet e 9 shkurtit lindën idetë për zgjedhje të reja, teksa situata është gati e pashembullt prej pavarësisë e këndej. LV-ja fitoi më së shumti vota në zgjedhje, por jo mjaftueshëm për të qeverisur vetë. Për pasojë, partitë më të mëdha kanë dështuar që të arrijnë konsensus për koalicion qeveritar, dhe janë bllokuar në një mori procesesh, duke nisur nga konstituimi i Kuvendit. Deputetët kanë mbajtur dhjetëra seanca, dhe kanë dalë disa aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo procesi nuk është finalizuar me sukses. Aktgjykimi i fundit ka të bëjë me ankesën e Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - lidhur me votimin ndaras të kandidatëve për nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e pakicave. Kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, e shpalli Kuvendin të konstituuar edhe pa zgjedhjen e një nënkryetari serb, por Gjykata konstatoi se diçka e tillë nuk

qëndron. Njohësit e çështjeve politike besojnë se fajin kryesor për situatën e krijuar e ka elita politike, e cila nuk është e interesuar për të gjetur zgjidhje. Disa, sikurse Dritëro Arifi, besojnë se fajin më të madh për situatën e krijuar e ka LV-ja. A do të prodhonin rezultat tjetër zgjedhjet e reja eventuale? Artan Muhaxhiri beson se po. "Sipas logjikës politike, do të duhej të kishte [rezultat tjetër], sepse kjo bllokadë ka ardhur kryesisht si pasojë e mungesës së vullnetit politik nga Lëvizja Vetëvendosje, e cila sërish i dëshironte 50 për qind", thotë ai. "Qytetarët e Kosovës do të duhej të votonin në atë mënyrë që t'ua impononin bashkëpunimin, sepse sistemi politik në Kosovë është i tillë që pa një bashkëpunim nuk mund të ketë rezultat".

Si mund të arrihet deri te zgjedhjet?

Në tekstet e plota të aktgjykimeve të lëshuara këtë vit nga Gjykata Kushtetuese lidhur me krizën në Kuvend, nuk është përmendur ndonjë masë ndëshkuese nëse nuk respektohen afatet kohore të vendimeve që ajo ka marrë. Arifi beson se ajo vepron kësisoj, pasi nuk mund ta paragjykojë vendimin që marrin deputetët. "Janë deputetë të zgjedhur, është

e vështirë që të penalizohen. Ajo vetëm vlerëson nëse një veprim ka qenë në harmoni me frymën dhe germën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo është krejt çfarë mund të bëjë ajo". Sipas tij, për të ndryshuar situatën do të nevojitet ndërhyrja e presidentes, Vjosa Osmani. "Presidentja do të duhet të ishte shumë më aktive, që ta kemi një Kuvend dhe një qeveri, që të lëvizim tutje, sepse jemi në muajin e 10-të që jemi vend i bllokuar, dhe askush nuk mund të jetë krenar për asgjë", vlerëson ai. As Muhaxhiri nuk beson se Kushtetuesja mund ta çojë vendin në zgjedhje, sepse kjo është çështje politike. "Gjithsesi, presidentja do të mund t'i ftonte liderët e partive politike dhe në bashkëpunim me ta të arrinte në konkluzion që zgjedhjet e reja janë e vetmja mënyrë që të dilet nga kjo bllokadë katastrofale që e ka pllakosur Kosovën prej 9 shkurtit". Ndërsa gëlojnë diskutimet për zgjedhjet e reja, faktori ndërkombëtar bën thirrje për zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe për formim të institucioneve sa më shpejt. Ndër më të fundit ishte apeli i ambasadorit të Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav: "Ju lutem, konstituojeni Kuvendin dhe ju lutem formojeni një qeveri". A do të ketë vesh që e dëgjojnë dhe respektojnë këtë lutje? Të shohim...

ALI AHMETI: KURTI PO PËRKRAH HAPUR POLITIKËN ANTI-SHQIPTARE TË KRISTIAN MICKOSKIT

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka thënë se Albin Kurti ka marrë anën e Kristian Mickosit në Maqedoninë e Veriut dhe se “nuk e kupton se çka po e shtyn ta bëjë këtë”. Në një intervistë për “Euronews Albania”, Ahmeti ka thënë se Kurti po përkrah politikën anti-shqiptare të Mickoskit. “Përse Albin Kurti merr anë? Në këtë situatë Albin Kurti ka marrë anë dukshëm, që mua nuk më pengon, le të marrë anë sepse politikën e mia janë ndryshe në aspektin e politikave kombëtare. Unë kam bashkëpunuar me të gjithë

politikanët në të gjitha vendet shqiptare, sepse neve si shqiptarë në Maqedoninë e Veriut na duhen raporte të mira me të gjithë shqiptarët. Albini ka marrë anë që në mënyrë indirekte, duket hapur në mbështetje të politikave anti-shqiptare të Mickosit”, ka theksuar Ahmeti në këtë intervistë. Ai ka listuar disa nga nismat që, sipas tij, ka ndërmarrë Mickoski si “politikë anti-shqiptare”. “Përderisa Hristjan Mickoski del hapur kundër Korridorit 8, e më vonë thotë është vepër shumë e madhe, por dy muaj televizionet

në Maqedoni janë marrë me korridorin 8, dhe ka qenë shumë irrituese për shqiptarët, derisa del në fushatë presidentja dhe kërkon hapjen e lëndëve në Tribunalin e Hagës për udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) - pra kërkesë e presidentes, kjo do të thotë të gërvishësh plagë të vjetra. Këto çështje ne i kemi mbyllë, Tribunalin e kemi mbyllë. Amnistia e UÇK-së dhe policisë e ushtrisë së shtetit, është mbyllur, të gërvishësh mbi plagë të vjetra, këto dhëmbin”, ka thënë Ahmeti. Ai ka thënë se shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë ‘të irrituar nga deklaratat e Albin

Kurtit për çështjen e gjuhës shqipe’. “Çka mund të them unë është që shqiptarët në Maqedoni janë tepër të irrituar nga deklaratat e kryeministrit të Kosovës ku ai deklaron se gjuha shqipe kurrë nuk ka qenë zyrtare në Maqedoni dhe revoltën që krijoi pa masë të shqiptarët. Anti-shqiptarët më të mëdhenj në Maqedoni e kanë mbajtur një muaj rresht në ekranet televizive, ja deklaratat e kryeministrit të Kosovës”. Ahmeti ka thënë se ka pasur takime të gjata e shteruese me Albin Kurtin, por se “nuk e kupton se ka çka e ka shtyrë që kaq hapur të prononcohet pro VLEN-it”.

“Unë kam pasur takime më herët me z. Kurti. E kam patur në selinë time me orë të tëra, pesë orë, gjashtë orë. Kam biseduar të gjitha çështjet e politikave të brendshme, rajonale. Unë kam folur pa rezervë, se çka e ka shtyrë zotin Kurti që kaq hapur të prononcohet dhe të marrë anë në drejtim të VLEN-it, që tani është LEN sepse është copëtuar”, ka deklaruar Ahmeti. Para pak ditësh Hysen Durmishi, një nga figurat kyçe të Lëvizjes Vetëvendosje, mori pjesë në një nga aktivitetet e VLEN-it në Maqedoninë e Veriut në përkrahje të tyre.



NIMANI: MUNGESA E MIRATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2026 BRENDË AFATIT LIGJOR, ALARM SERIOZ PËR SHTETIN TONË

Faton DËRMAKU
PRISHTINË, 3 TETOR - Profesori universitar Artan Nimani ka thënë se mungesa e miratimit të buxhetit të vitit 2026 brenda afatit ligjor është një alarm serioz për shtetin tonë. “Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr. 03/L-048), i ndryshuar dhe plotësuar më vonë, është i qartë: Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar të miratojë buxhetin para përfundimit të vitit fiskal, përkatësisht deri më 31 dhjetor. Në të kundërtën, të gjitha ndarjet buxhetore skadojnë dhe vendi hyn në një vakum financiar e institucional”, ka thënë ai. Nimani ka theksuar se pasojat nuk janë thjesht teknike, por prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. “Pa buxhet të miratuar: Administrata

publike rrezikon të mbetet pa paga. Projektet kapitale dhe zhvillimore ndalen menjëherë. Bizneset që varen nga kontratat publike mbeten pezull. Shërbimet bazike për qytetarët dobësohen. Ligji një vetëm një mundësi zgjatjeje të përkohshme të shpenzimeve, për maksimum tre muaj, në rast vonesash apo zgjedhesh, duke u bazuar në një të dymbëdhjetën e buxhetit të vitit paraprak. Pas këtij afati, asnjë institucion nuk ka të drejtë të kryejë shpenzime, përveç shlyerjes së borxhit publik të ligjshëm”, ka thënë profesori Nimani. Ai ka thënë se ky është standard i njohur edhe në praktikën ndërkombëtare të menaxhimit fiskal, ku vonesat në miratimin e buxhetit konsiderohen rrezik për stabilitetin makroekonomik dhe besueshmërinë e shtetit. “Nëse lejojmë që vendi të mbetet pa



buxhet, atëherë jo vetëm që paralizohet qeverisja, por cenohet edhe kontrata sociale mes shtetit dhe qytetarëve. Në një kohë kur ekonomia është e brishtë dhe

varfëria prek çdo ditë më shumë familje, mungesa e përgjegjësisë politike do të ishte goditje fatale. Unë nuk dua të imagjinoj Kosovën pa buxhet të miratuar. Përgjegjësia

është mbi supet e përfaqësuesve të Kuvendit dhe të Qeverisë, ligji është i qartë, praktikën janë të njohura, pasojat janë të parashikueshme. Të luash me buxhetin do të thotë të luash me jetën dhe sigurinë e qytetarëve të vendit tënd”, ka shkruar Nimani në “Facebook”. Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim më 30 shtator që seanca konstituive e Kuvendit, e nisur më 15 prill, nuk ka përfunduar dhe që ajo duhet të përfundojë brenda 12 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi. Gjykata e ka arsyetuar vendimin e saj, duke përmendur se ende nuk është zgjedhur nënkryetari i Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit serb. Ajo i ka urdhëruar deputetët që në pajtim me nenet në fuqi ta ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në të mirë të interesit të Kosovës, kur ta zgjedhin nënkryetarin nga ky komunitet.

ULUTASH RIKTHEHET NË KOMANDËN E KFOR-it

PRISHTINË, 3 TETOR - Gjeneralmajori turk Ozkan Ulutash ka rimarrë detyrën e komandantit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Ai zëvendëson në krye të KFOR-it gjeneralmajorin italian Enrico Barduanin, i cili më 11 tetor 2024 kishte marrë udhëheqjen e misionit pikërisht nga gjenerali Ulutash. “Ne jemi të gatshëm dhe plotësisht të përkushtuar për ta përmbushur misionin tonë për paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe për stabilitetin rajonal. Do ta bëjmë këtë përmes aktiviteteve të ndryshme në terren, por edhe përmes mbështetjes sonë të fuqishme për dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Beogradit dhe Prishtinës, që është rruga drejt stabilitetit”, tha Ulutash. Ulutash falënderoi paraardhësin e tij për punën e bërë dhe tha se është i gatshëm të punojë drejt konsolidimit të mëtejshme me autoritetet e Kosovës. “Llogaris në vazhdimin e bashkëpunimit me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in, në rolet e tyre respektive të sigurisë”, tha Ulutash. Komandanti i 30 i KFOR-it tha se misioni ka prani në mbarë Kosovën dhe “është i gatshëm të trajtojë çdo zhvillim të sigurisë”. Ulutash tha se mbetet të përmbushet prioriteti i misionit të KFOR-it për të ofruar mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet. Kjo është hera e dytë që KFOR-i udhëhiqet nga një komandat turk. Mandati i parë njëvjeçar i Ulutashit në krye të KFOR-it nisi

në tetor të vitit 2023 dhe përfundoi në tetor të vitit pasues.

Barduani: Ka ende shqetësime të sigurisë për shkak të çështjeve të pazgjidhura

Gjeneralmajor Enrico Barduani, gjatë fjalimit në ceremoninë e ndërrimit të komandës, tha se situata e sigurisë në Kosovë është stabile, por e brishtë. “Ka ende shqetësime për sigurinë afatgjatë për shkak të disa çështjeve ende të pazgjidhura. Prandaj, roli i KFOR-it këtu ende i rëndësishëm”, tha ai. Sipas Barduanit, nga të gjitha dislokimet që ka pasur në mbarë botën, shërbimi i tij në Kosovë ka qenë më sfiduesi. “Këtu çdo ngjarje e vogël, qoftë edhe të një magnitudë të vogël, çdo veprim dhe fjalë, mund të ketë pasoja strategjike, në kontekstin që mbetet stabil, por i brishtë”, tha ai. KFOR-i, tha Barduani, vazhdon ta mbështesë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. “Dialogu i lehtësuar nga BE-ja është kornizë për zgjidhjen e çështjeve të hapura dhe të arrihen zgjidhje që respektojnë të drejtat e të gjitha komuniteteve. Ky është kyç për një stabilitet afatgjatë”, theksoi ai. Në këtë drejtim, ai tha se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, dhe “të dyja të tregojnë fleksibilitet për t'i arritur kompromiset e nevojshme”. “Politikanët e mençur duhet të



punojnë në të mirë të popullit të tyre dhe për të ardhmen e shtetit të tyre. Prandaj, ata duhet të jenë të gatshëm të bëjnë kompromise”, tha Barduani, duke shtuar se udhëheqja politike duhet të ndjekë zgjidhje afatgjatë për disa çështje të pazgjidhura që ende prekin stabilitetin e Kosovës: “Nëse e shikojmë skenarin e sigurisë në mbarë botën sot, jam i sigurt se tani më shumë se kurrë na duhet udhëheqje politike që ndjek zgjidhje afatgjatë për disa çështje të pazgjidhura që ende prekin stabilitetin e Kosovës dhe rajonit”, shtoi komandanti i 29 i KFOR-it. Të pranishëm në ceremoninë e ndërrimit të komandës të KFOR-it ishin të pranishëm edhe zyrtarë institucionalë të Kosovës. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se populli i Kosovës është mirënjohës për kontributin e misionit të NATO-s. “Populli i Kosovës gjithmonë ka qenë në linjë me vlerat e lirisë dhe sigurisë kolektive. Prandaj, aspirata jonë

për t'iu bashkuar NATO-s nuk është vetëm zgjedhje strategjike, por reflektim i asaj që jemi ne”, tha ajo. Sipas Osmanit, në kohën kur kërcënimet për paqe po shtohen, aleanca e NATO-s është më e fuqishme kur qëndron së bashku me partnerët që kanë dëshmuar përkushtimin e tyre për paqe. “Kosova e ka bërë këtë përmes qëndresës sonë, reformave dhe vendosmërisë së popullit tonë. Duhet të jemi të qartë, ka të tillë që duan të zhbëjnë atë që së bashku e kemi arritur, ata duan të na kthejnë në të kaluarën. Përgjigjja jonë ndaj tyre duhet të jetë e qartë: lajkatimi i diktatorëve dhe autokratëve nuk duhet të jetë përgjigjja siç na tregon historia. Nuk duhet t'u mundësohet partneriteti atyre që kryejnë agresion ndaj fqinjëve”, tha Osmani. Deklarata të ngjashme Osmani bëri edhe një ditë më parë, kur tha se Serbia dhe Rusia paraqesin kërcënim për Kosovën. Ajo kërkoi nga Bashkimi Evropian që të mos

“e shpërblejë Serbinë”, pasi argumentoi se ajo është partnere e Moskës dhe se ka “përdorur taktika të agresionit dhe destabilizimit ndaj fqinjëve”, duke përmendur sulmin në Banjskë të Zveçanit më 2023, për të cilin Kosova fajëson Serbinë.

Kush është Ulutash?

Karriera e tij ushtarake nisi pasi e përfundoi shkollën e mesme ushtarake më 1985 dhe Akademinë Ushtarake në vitin 1989. Që nga viti 2021 ka shërbyer drejtor për strategji në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë, ndërsa më parë kishte qenë komandant i përgjithshëm i Forcës së Reagimit të Shpejtë të NATO-s në Turqi. Më parë, Ulutash kishte mbajtur edhe pozita të tjera ushtarake, si: zëvendëskomandant i sektorit të Komandës së Përbashkët të NATO-s në Norfolk, drejtor i Qendrës për Studime Historike Ushtarake në Ankara dhe zëvendëskomandant i Garnizonit të Brigadës së 28 të Këmbësorisë së Mekanizuar. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. Misioni i NATO-s, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë. NATO-ja e shtoi praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriu e banuar me shumicë serbe. Në KFOR aktualisht janë 4 649 paqeruajtës nga 33 shtete.

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE MBETET PRIORITET KYÇ I QEVERISË

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministria e Punëve të Brendshme mbajti takimin e radhës së Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike (KMRAP), me qëllim të raportimit të të arriturave gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, i cili e udhëhoqi takimin e Këshillit të Ministrave për RAP-in, pasi falënderoi kolegët ministra e zëvendësministra anëtarë të KMRAP, theksoi se ashtu siç është paraparë në programin



qeverisë, reforma e administratës publike mbetet prioritet kyç i Qeverisë së Kosovës. Me këtë rast, zëvendësministri

Dobra vuri në dukje se RAP synon ndryshimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve përmes krijimit të

një administrate moderne dhe të aftë, që ndihmon po ashtu edhe në përmbylljen e suksesshme të integritetit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. Zëvendësministri Dobra ka konstatuar se zbatimi i Planit të rishikuar të veprimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 ka shënuar përparim kundrejt planifikimit në masën prej 62 % të aktiviteteve të planifikuara, por që mbetet ende angazhim drejt realizimit të plotë. Në këtë takim u miratua edhe raporti gjashtëmujor mbi zbatimin e Planit të veprimit për vitin 2025 të Strategjisë për

Reformën e Administratës Publike 2022-2027. Kjo strategji është dokumenti kryesor për fushën e administratës publike dhe reflekton përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë në funksion të përmirësimit, reformimit dhe modernizimit të gjithëmbarshtëm të kësaj fushe. Në fund të takimit zëvendësministri Dobra kërkoi rritje të angazhimit, përkushtimit dhe bashkëpunimit të ngushtë të institucioneve, për të siguruar një funksionim më të mirë dhe qëndrueshëm të administratës publike përmes zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit efektiv të politikave të qeverisë.

Përparim Rama përkrah kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së

Prishtinë, 3 tetor - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar të premtën organizatën e OVLUÇK-së në kryeqytet. Ai është pritur nga kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe


bashkëpunëtorët e tij. Rama ka thënë se kryeqyteti është i vetmi qytet në Kosovë dhe rajon që ka themeluar sektorin për mbrojtjen e kategorive të dala nga lufta në kuadër të kabinetit

të kryetarit. “Për këtë jemi shumë krenarë. Kemi përkrahur dhe do të vazhdojmë të përkrahim lavdinë tonë kombëtare. Sot, organizatat e veteranëve të luftës na priten në

vizitë dhe bashkë biseduam për vazhdimësinë e punës dhe bashkëpunimit tonë. Të bashkuar gjithmonë për të mirën e vendit!”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



MILIONAT E HUMBUR NGA KONTRATAT KOLEKTIVE: KOMUNAT KËRKOJNË PËRGJEGJËSI NGA QEVERIA



Prishtinë, 3 tetor - Shumica e përfitimeve nga kontratat kolektive në arsim dhe shëndetësi mbeten të papaguara derisa punonjësit të drejtohen në gjykatë. Komunitet detyrohen t'i shlyejnë vendimet gjyqësore, duke përdorur fonde të parashikuara për investime kapitale dhe shërbime publike. Pa një linjë të veçantë buxhetore nga qeveria, problemet financiare për komunitet mbeten të pazgjidhura dhe pengojnë zhvillimin lokal.

Ahmet Pllana, arsimtar i historisë me 40 vjet përvojë në Shkollën Fillore "Dardania" në Prishtinë, mori mbi pesë mijë euro për përfitimet që i takonin sipas kontratës kolektive, por vetëm pas pensionimit në vitin 2022.

Një pjesë e këtyre parave duhej t'i ishin paguar gjatë viteve të punës, por pagesa u vonua dhe u bë e mundur vetëm pas vendimeve gjyqësore. "Pagën jubilarë dhe tri pagat e pensionimit i mora nga komuna pa gjyq. Por, për shujtën dhe pagesën për kualifikim u detyrova të shkoj në gjykatë, dhe vetëm pas dy vjetësh mora 2 800 euro për kualifikim dhe 1 800 euro për shujtën", tregon Pllana për "Radion Evropa e Lirë".

Që nga viti 2014 Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Arsimit në Kosovë kanë nënshkruar së paku tri kontrata kolektive për t'i përmirësuar të drejtat e punëtorëve, por ato nuk janë zbatuar plotësisht dhe, ndërkohë, janë ndërprerë. Si rezultat, shumë punonjës të arsimit kanë shkuar në gjykata për t'i marrë përfitimet që u takonin dhe shpesh gjykatat kanë vendosur në favor të tyre.

Kontrata e fundit kolektive në arsim u nënshkrua në vitin 2021, por u ndërpre njëanshmërisht nga Ministria e Arsimit në vitin 2022, me arsyetimin se nuk është

Përfitimet nga kontratat kolektive në arsim

Kontratat kolektive në arsim parashohin: Pagë jubilarë: për mbi dhjetë vjet përvojë pune, 50 % e pagës bazë, deri në më shumë se 40 vjet përvojë, 150 % e pagës bazë. Tri paga pas daljes në pension. Kompensim për përvojën e punës: 0.5 % të pagës bazë për çdo vit pune. Shujtë ditore: 2 euro për ditë. Udhëtim në vendbanimet e komunës: 70 % e çmimit të biletës urbane. Rritje për inflacion.

menaxhuar siç duhet.

Problemi financiar i komunave

Ligjërish, këto përfitime duhet të paguheshin nga komunitet, por qeveria qendrore nuk u ka dhënë atyre buxhet shtesë. Në rastet kur këto përfitime nuk janë dhënë, punonjësit e arsimit dhe të shëndetësisë - të cilët gjithashtu përfitojnë nga kontratat kolektive - kanë kërkuar drejtësi përmes gjykatave. "Në tre vjetët e fundit mbi 60 mijë mësimitdhënës në nivel vendi u janë drejtuar gjykatave dhe të gjithë i kanë fituar rastet", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Rrahman Jasharaj, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK). Ai shton se kjo është e padrejtë, pasi kontratat janë nënshkruar me nivelin qendror, ndërsa përgjegjësia financiare u bie komunave si punëdhënëse të punëtorëve të arsimit, por edhe të shëndetësisë. Sipas një raporti të publikuar në maj të këtij viti nga Instituti për Studime të Avancuara GAP, me titull "Në kërkim të zgjidhjes: Problemet përmbarimore në komuna", kontratat kolektive në sektorin e shëndetësisë është nënshkruar fillimisht në vitin 2015 e më pas në

vitin 2018.

Ajo ka qenë në fuqi deri në fund të vitit 2021. Dhe, ndryshe nga arsimi, kjo kontratë parashihte edhe pagesën e rrogës së trembëdhjetë vjetore. Shërbyesit civilë janë duke kërkuar, po ashtu, kompensime përmes gjykatave, kryesisht për shujta dhe shpenzimet për transport. Përmbaruesit për kthimin e këtyre kompensimeve janë duke i paguar komunitet. Raporti i GAP-it tregon se gjatë vitit 2024 disa komuna kishin shpenzime përmbarimore më të larta se të hyrat vetjake, ndërsa në disa të tjera këto shpenzime i tejkaluan investimet kapitale.

Milionat për vendime gjyqësore

Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nga viti 2022 deri në gusht të këtij viti, komunitet e Kosovës kanë paguar mbi 236 milionë euro për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Sipas tij, shumica më e madhe lidhet me kontratat kolektive në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. "Vetëm nga janari deri në gusht të këtij viti janë paguar 73.5 milionë euro. Prej

tyre, mbi 40 milionë janë marrë nga investimet kapitale të komunave, mbi 24 milionë nga mallrat dhe shërbimet, 5.6 milionë nga subvencionet dhe transferet, si dhe 3 milionë nga faturat komunale", shpjegon Ibrahim.

Ai thotë se kontratat janë nënshkruar pa konsultim paraprak me komunitet, pa vlerësim të ndikimit buxhetor dhe pa koordinim, duke bërë që barra financiare të bjerë padrejtësisht mbi komuna. "Ata që i kanë nënshkruar kontratat, duhet të marrin përgjegjësi, si institucionale, ashtu edhe financiare. Komunitet nuk i kanë nënshkruar, as ne si Asociacion. Qeveria i ka nënshkruar, pa marrë parasysh se kur dhe kush. Prandaj, përgjegjësia duhet të bjerë mbi nivelin qendror, jo atë lokal", thotë Ibrahim.

"Radio Evropa e Lirë" kontaktoi Ministrinë në detyrë të Financave, e cila ndan buxhetin, për të pyetur nëse në buxhetin e vitit të ardhshëm do të krijohet një linjë e veçantë për këto shpenzime, ose nëse do të rimbursohen mjetet që komunitet kanë shpenzuar deri më tani për kompensimet e punonjësve, por nuk mori asnjë përgjigje.

Ibrahim thotë se kjo situatë ka penguar zbatimin e shumë planeve zhvillimore në komunitet e Kosovës, duke i kufizuar ato në projekte kapitale që do të përmirësonin jetën e qytetarëve. Ngjashëm theksohet edhe në raportin e Institutit GAP. "Komunitet mbeten me mjete të pamjaftueshme për projekte zhvillimore, si ndërtimi i infrastrukturës, renovimi i shkollave, përmirësimi i shërbimeve komunale, investimet në zhvillim ekonomik lokal dhe përmirësimi i nevojave të

qytetarëve, që do të ndikonin në përmirësimin e cilësisë së jetës", thekson raporti.

Aty, po ashtu, thuhet se dy kontratat kolektive në arsim, më 2017 dhe 2021, janë nënshkruar në prag të zgjedhjeve, pa vlerësim të ndikimit financiar nga institucionet. Ndaj, sipas GAP-it, palët kanë llogaritur më shumë në përfitime elektorale sesa në zgjidhje të qëndrueshme.

Cila është zgjidhja?

Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës, çështja e shpenzimeve për kontratat kolektive mund të zgjidhet lehtë nëse Qeveria dhe Kuvendi parashohin një linjë të veçantë buxhetore në nivel qendror. "Me kaq mund të përfundojë kjo problematikë", thotë Ibrahim.

Edhe raporti i GAP-it thekson se niveli qendror mban përgjegjësinë për obligimet përmbarimore, pasi është sponsorizues i ligjeve dhe kontratave. "Qeveria duhet të marrë përsipër ekzekutimin e pagesave që dalin nga vendimet gjyqësore për çështjen në fjalë", thuhet në raport.

Komunitet këtë vit kanë pasur në dispozicion rreth 843 milionë euro, ndërsa sipas Qarkores buxhetore për vitin 2026, buxheti i dedikuar për to do të jetë 867 milionë euro. Në gusht të vitit 2022, 26 komuna paditën Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë për kthimin e mjeteve financiare. Paditë u bënë në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe u bartën në Gjykatën Komerciale, por deri tani nuk është marrë ndonjë vendim.

E kontaktuar nga "REL"-i, Gjykata nuk ka dhënë informacione nëse i ka shqyrtuar këto padi.

PESË VJET PADREJTËSI, PESË VJET KRENARI PËR UÇK-në



Shkruan: Shqiptar
GUBETINI

Saktësisht po bëhen pesë vjet prej kur ish-drejtuessit e UÇK-së dhe institucioneve të Kosovës po mbahen padrejtësisht në paraburgim, në qelitë e ftohta të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Pesë vjet më vonë shumëçka ka ndryshuar nga fillimi i nëntorit të vitit 2020, por ajo që nuk ka ndryshuar dhe që forcohet çdo ditë e më shumë është krenaria e pashuar për UÇK-në - ushtrinë që ia solli lirinë këtij vendi.

Sot, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi nuk u mungojnë vetëm familjeve e miqve të tyre. Ata i mungojnë Kosovës, institucioneve, popullit dhe

gjithë kombit shqiptar.

Më 14 shtator në Hagë u mbajt një protestë e madhe, ku mërgimtarë e veteranë nga të gjitha anët e botës u bashkuan nën një zë. U brohorit fuqishëm se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë, çlirimtare dhe e domosdoshme. Nuk u mbloodhëm për të mohuar drejtësinë, por për të kërkuar drejtësi. Mesazhi ishte i qartë: askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës! Në fytyrat e secilit shihej shpresa, që edhe në fund të këtij tuneli të gjatë do të lindë një dritë.

Populli i Kosovës e ka përjetuar pastrimin etnik dhe masakrat më të tmerrshme në Evropën e fundit të shekullit XX, ndërsa autorët e atyre krimeve ende nuk kanë dalë para drejtësisë. Në anën tjetër, përpjekjet për ta barazuar viktimën me agresorin nuk kanë qenë kurrë më të

theksuara. Kjo padrejtësi i dhemb çdo shqiptari, kudo që jeton. Protestat në Prishtinë dhe ato në Hagë janë dëshmi se populli nuk i harron bijtë e tij më të mirë dhe do të qëndrojë pranë tyre në çdo rrethanë. Në këto pesë vite të mungesës së tyre fizike, shteti ka humbur drejtimin e duhur, është shmangur nga rruga që kishin trasuar presidenti Thaçi dhe bashkëluftëtarët e tij, sidomos në qasjen e ndërtimit të raporteve me miqtë ndërkombëtarë.

Prandaj sot, të gjithë pa dallim, presin fundin e kësaj maratone me shpresën dhe besimin e madh se Hashim Thaçi, Kadri



Veseli, Rexhep Selimi e Jakup Krasniqi do të rikthehen në Kosovë - për të vazhduar konsolidimin e shtetit dhe forcimin e lirisë për të cilën dhanë jetën mijëra dëshmorë të kombit.

Populli shqiptar ka vuajtur brez pas brezi, dhe lufta e UÇK-së ishte vula e përpjekjeve shekullore për liri e pavarësi. Ky është çmimi që po paguajmë edhe sot. Edhe pse padrejtësisht në qeli, Thaçi e shokët e tij janë sërish në krye të detyrës, sepse po mbajnë mbi supë një betejë të re për dinjitetin e Kosovës. Të gjithë jemi të bindur se, pavarësisht errësirës së sotme, një ditë - DIELLI DO TË LIND PËRSËRI!



Reshjet e borës në Kosovë shkaktojnë prishje në rrjetin elektrik shpërndarës

PRISHTINË, 3 TETOR - Për shkak të reshjeve të borës që përfshinë vendin tonë, janë shkaktuar disa prishje në rrjetin elektrik shpërndarës, duke lënë një numër të

caktuar të konsumatorëve pa furnizim me energji elektrike. Rajonet më të prekura janë Prishtina, Gjilani, Prizreni dhe Mitrovica, ku disa dalje janë jashtë funksionit.

KEDS-i ka njoftuar se ka mobilizuar ekiye shtesë edhe nga rajone të tjera, të cilat, pavarësisht prej rrethanave të vështira në terren, po përkushtohen që t'i

eliminojnë sa më parë dëmet e shkaktuara në rrjet, dhe në një afat sa më optimal konsumatorëve tanë t'u rikthehet furnizimi me energji elektrike.



AKTAKUZË NDAJ DY PERSONAVE TË DYSHUAR PËR FAJDE DHE MASHTRIM NË VLERË MBI 6 MILIONË EURO

PRISHTINË, 3 TETOR - Autoritetet e Kosovës kanë ngritur aktakuzë ndaj dy personave të dyshuar për fajde dhe disa vepra të tjera penale, duke i akuzuar ata për shkaktimin e dëmeve në vlerë mbi gjashtë milionë euro. Prokuroria Speciale e Kosovës përmes një njoftimi për medie i identifikoi të akuzuarit vetëm si B. M dhe Q. M dhe tha se ata ngarkohen edhe me vepra të tjera, si mashtrimi, shpëlarja e parave, falsifikimi i dokumenteve dhe kanosja. Që të dy akuzohen se gjatë vitit 2020, në kundërshtim me ligjin, kishin “kontraktuar një shumë të konsiderueshme dhe

joproporcionale të pasurisë në këmbim të një shërbimi ndaj të dëmtuarit, duke i dhënë atij para me fajde disa herë”. Prokurorët thonë se të pandehurit më pas ia kanë tjetërsuar të dëmtuarit pronën në Prishtinë, pasi ai nuk kishte qenë në gjendje t’ua kthente hollat. Gjithashtu, ata akuzohen se “në bashkëryerje, duke e ditur se pasuria rrjedh nga aktiviteti kriminal, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore dhe të fshehjes së vlerës reale, në mënyrë të kundërligjshme e konvertojnë, duke u shkaktuar dëm të dëmtuarve në vlerë prej 6 300 000.00 eurosh”.

Në muajt e fundit autoritetet e sigurisë i kanë luftuar fajdetë. Ditë më parë Prokuroria Themelore në Prizren ngriti aktakuzë ndaj gjashtë personave të cilët dyshohet se, veç e veç, morën fajde, që në total arrin vlerën e 1.4 milion eurove. Autoritetet kanë kërkuar të bëhet konfiskimi dhe kthimi i 21 banesave dhe lokaleve afariste, që u ishin dhënë të akuzuarve nga të dëmtuarit, pasi ata nuk mund t'ua kthenin borxhin. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që gjendet fajtor për fajde mund të dënohet me gjobë, si dhe me burgim nga



gjashtë muaj deri në pesë vjet. Nëse kjo vepër penal shkakton humbje financiare për të dëmtuarin në shumën mbi 10

mijë euro dhe nëse kryesi ka përfituar pasuri po kaq, ai mund të dënohet me gjobë dhe burgim nga një deri në tetë vjet.

AKB-ja: KOSOVA NË PRAG TË KOLAPSTIT EKONOMIK, RRITE VARFËRIA DHE TKURRJA E POPULLSISË

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 TETOT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Bordit Udhëheqës, në të cilën u diskutua për sfidat më të mëdha që po kalon ekonomia e Kosovës dhe rreziqet serioze që po i kanosen stabilitetit ekonomik, social dhe politik të vendit. Në këtë mbledhje u trajtuan tema jetike si: siguria juridike e investitorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, gjendja e prodhuesve vendorë, tregtia dhe shërbimet, ndërtimtaria, tregu i derivateve të naftës, energjia elektrike pas shtrenjtimit, vjelja e rrushit 2025, sektori i mallrave dhe tekstilit, si dhe pasojat e përjashtimit të Kosovës nga dialogu strategjik me ShBA-në. Bordi i AKB-së ngriti shqetësime të mëdha për gjendjen aktuale: Rritja e çmimeve ka rënduar jetën e qytetarëve dhe ka ulur fuqinë blerëse të familjeve; Inflacioni i lartë po gërryen të ardhurat dhe



po rrezikon bizneset; Varfëria është në rritje, duke shtyrë shumë familje drejt pamundësisë për ta përballuar jetesën. “Importi për vitin 2025 pritet të arrijë rreth 7 miliardë euro, duke dëshmuar dobësinë e prodhimit vendor dhe

varësinë e skajshme nga jashtë. Investimet në ndërtimtari kapin shifrën e 9 miliardë eurove, por ky kapital mbetet i vdekur, pa krijuar vende pune të qëndrueshme apo zhvillim industrial. Popullsia e Kosovës është tkurrur rreth 10%

vetëm në vitin e fundit, duke e bërë Kosovën vendin me rënien më të shpejtë demografike në botë”, thuhet në komunikatën e AKB-së. Këto shifra alarmante, sipas AKB-së, tregojnë se ekonomia e

Kosovës ndodhet në një udhëkryq të rrezikshëm, ku mungesa e strategjive zhvillimore dhe pasiviteti institucional po e çojnë vendin drejt krizës së thellë ekonomike dhe sociale. Në takim morën pjesë anëtarët e kryesisë së AKB-së: Agim Shahini, Arianit Koci, Shkëlzen Jusaj, Haziz Tafaj, Ahmet Kuqi dhe Isak Tusha, të cilët dhanë kontribut të çmuar me analiza dhe propozime konkrete për ta nxjerrë vendin nga kjo gjendje e rënduar. Në fund të mbledhjes, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se Kosova po kalon një nga periudhat më të vështira të saj, ku rritja e çmimeve, inflacioni, varfëria, emigrimi dhe tkurrja e popullsisë po e rrezikojnë seriozisht të ardhmen e vendit. “Nëse institucionet nuk veprojnë me urgjencë për ta mbrojtur ekonominë dhe për t'i fuqizuar prodhuesit vendorë, Kosova rrezikon të boshatiset dhe të mbetet një treg i varur vetëm nga importi. Kjo është koha e fundit për ndryshim”, ka thënë Shahini.

Auditorja e përgjithshme dhe rektori i UBT-së bien dakord për ripërtëritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit

PRISHTINË, 3 TETOR - Auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, së bashku me zëvendësauditorin e përgjithshëm, Beza Halilaj, dhe ndihmësauditorin e

përgjithshme, Myrvete Gashi, zhvilluan takim me rektorin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), prof. dr. Edmond Hajrizi. Në takim u diskutua ripërtëritja e

marrëveshjes së bashkëpunimit dhe mundësitë që kjo hapë për të ardhmen përmes fuqizimit të kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimit të përvojave. Palët u pajtuan që përmes kësaj

marrëveshjeje ta forcojnë partneritetin dhe të kontribuojnë në zhvillimin profesional, me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimit të përvojave në fusha me interes të përbashkët.





eg
EURO
GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Maintenance
Servicing
Repair



Zyrtare: Nevil Dede, trajner i ri i Ferizajt

FERIZAJ, 3 TETOR - FC Ferizaj është bërë me trajner të ri. Drejtimin e klubit ferizajas e ka marrë trajneri Nevil Dede. Lajmin e ka bërë me dije FC

Ferizaj përmes një njoftimi publik. “Me përvojë të gjatë si lojtar dhe trajner në futbollin shqiptar, Dede sjell profesionalizëm dhe

përkushtim të madh, me synim ngritjen e nivelit të skuadrës dhe arritjen e rezultateve pozitive”, ka njoftuar FC Ferizaj.

Nevil Dede do ta zëvendësojë Arsim Abazin, i cili është largua nga Ferizaj pas rezultateve të dobëta në sezonin e ri në Superligë.



KOSOVA PUBLIKON LISTËN E FUTBOLLISTËVE PËR NDESHJET E TETORIT

PRISHTINË, 3 TETOR - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës (FFK), Franco Foda, ka bërë publike listën e futbollistëve të ftuar për dy ndeshjet kualifikuese të Kampionatit Botëror 2026 që zhvillohen në muajin tetor, kundër Sllovenisë dhe Suedisë. Në listën e publikuar këtë herë janë ftuar 27 futbollistë nga Foda, ndërsa në listën rezervë figurojnë edhe nëntë emra të tjerë. Emri i ri në listën e “Dardanëve” është ai i Alban Hajdarit, teksa është kthyer Edon Zhegrova, Ron Raçi dhe Leard Sadriu.



Pjesë e listës janë edhe “veteranët” si Vedat Muriqi, Valon Berisha, Milot Rashica, Fidan Aliti dhe Mërgim Vojvoda, teksa mungon kapiteni Amir Rrahmani. Në listën rezervë gjenden emra si Faton Maloku, Kreshnik Krasniqi, Behar Neziri, Ismet Lushaku, Bledian Krasniqi, Andi Hoti, Rilind Nivokazi, Bersant Celina dhe Donat Rudhani. “Dardanët” do ta nisin grumbullimin të hënën, më 6 tetor, me stërvitjen e parë që zhvillohet në orën 17:00 në Kampin Nacional të FFK-së në

Hajvali. Më herët, në orën 12:00, Foda do të mbajë konferencën e zakonshme për medie. Kosova do të përballet fillimisht me Slloveninë më 10 tetor, në orën 20:45, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Tri ditë më vonë, më 13 tetor, në të njëjtën orë, dardanët luajnë në Goteborg kundër Suedisë. Pas dy ndeshjeve të para të këtij cikli kualifikues, Kosova renditet e dyta në Grupin B me 3 pikë. Kryeson Zvicra me 6 pikë, ndërsa Suedia dhe Sllovenia kanë nga një pikë.

SYLVINHO PUBLIKON LISTËN E SHQIPËRISË PËR NDESHJET E TETORIT NDAJ SERBISË DHE JORDANISË

Tiranë, 3 tetor - Trajneri i Kombëtares shqiptare, Silvinjo, ka publikuar listën e lojtarëve të grumbulluar për dy ndeshjet e muajit tetor, sfidën kualifikuese të Kupës së Botës kundër Serbisë dhe miqësoren ndaj Jordanisë. Tekniku kuqezi ka thirrur 25 lojtarë dhe risia e vetme është futbollisti i Shkëndijës së Tetovës, Klisman Cake. Qendërmbrojtësi ka qenë më parë pjesë e Kombëtares U-21 dhe pas paraqitjeve të mira me Shkëndijën, ku arritën edhe

kualifikimin historik në Conference League, ka bindur trajnerin Silvinjo për ta ftuar në kombëtare. Grumbullimi i kombëtares nis të hënën, më 6 tetor, në Tiranë, ku kuqezinjtë do të përgatiten fillimisht për sfidën kualifikuese të Kupës së Botës ndaj Serbisë, e cila do të luhet më 11 tetor në stadiumin “Gradski stadion Dubočica” në Leskovac, në orën 20:45. Ndeshja miqësore Shqipëri - Jordani do të zhvillohet më 14 tetor në “Air Albania” në orën 19:00..



Lista e plotë:

Portierë: Thomas Strakosha, Mario Dajsinani dhe Simon Simoni
Mbrojtës: Elseid Hysaj, Ivan Balliu, Mario Mitaj, Naser Aliji, Ardian Ismajli, Enea Mihaj, Berat Gjimeshi, Arlind Ajeti dhe Klisman Cake
Mesfushorë: Ylber Ramadani, Julian Shehu, Kristjan Asllani, Medon Berisha, Qazim Laçi, Adrion Pajaziti, Nedim Bajrami, Arbër Hoxha dhe Jasir Asani
Sulmues: Armando Broja, Myrto Uzuni, Rey Manaj dhe Mirlind Daku

DRITA DEBUTON ME BARAZIM NË UEFA CONFERENCE LEAGUE



TAMPERE, 3 TETOR - Kampionia e Kosovës në futboll, FC Drita, e ka nisur me barazim aventurën në fazën e ligës në UEFA Conference League. Në udhëtimin e largët në Tampere, ekipi i drejtuar nga trajneri Zekirija Ramadani arriti të marrë një pikë në ndeshjen

kundër KuPS-it të Finlandës. Ndeshja e zhvilluar të enjten mbrëma përfundoi me rezultat 1:1. Për vendasit ka shënuar sulmuesi polak Piotr Parazyszek në minutën e 75-të, duke kaluar KuPS-in në avantazh. Por, FC

Drita nuk është dorëzuar duke reaguar shpejt, kur në minutën e 80 Albert Dabiqaj ka barazuar rezultatin me një goditje të bukur me kokë, duke siguruar rezultatin përfundimtar 1:1. Ky barazim në transfertë i jep FC Dritës një start pozitiv në garën

evropiane dhe përforcon aspiratat e klubit për të marrë sa më shumë pikë në ndeshjet e radhës. Ndeshjen e radhës në Evropë skuadra gjilanase e zhvillon më 23 tetor në orën 18:45 në stadiumin “Fadil Vokrri” kundër skuadrës qipriote, Omonoia.

FIFA zbulon topin që do të përdoret në Kupën e Botës, quhet ‘Trionda’

ZURICH, 3 TETOR - FIFA zyrtarisht ka zbuluar topin që do të përdoret në Kampionatin Botëror të Futbollit 2026, të organizuar së bashku nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe

Meksika. Ai quhet “Trionda” dhe është krijuar nga “Adidas”, që prej vitit 1970 furnizon topat zyrtarë për Botërorët. Emri “Trionda” është kombinim i dy fjalëve: “Tri” që nënkupton tre (të tre vendet

nikoqire) dhe “Onda” që në spanjisht dhe portugalisht do të thotë “valë”. Pra “tri valë” - simbolika e bashkëpunimit dhe energjisë që vjen nga tri vendet nikoqire. “Trionda” do të ketë një

“chip sensorik” që dërgon informacion për lëvizjet e topit te sistemi i VAR-it për vendime më të sakta dhe të shpejta, sidomos për offside ose situata të tjera që varen nga lëvizja e topit.





Në mbështetje të nenit 21.1 dhe nenit 25 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2021, lidhur me nenin 22 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 19.04.2018, e duke u bazuar në Vendimin e Komisionit të Auditimit me nr. të protokollit 52/25 të datës 29.09.2025, N.P.L “Përparimi” Sh. A, me datë 03.10.2025, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM
(Për plotësimin e vendit të lirë për pozitën e punës “Zyrtar për Auditim të Brendshëm”)

I. Titulli: Zyrtar për Auditim të Brendshëm

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar në periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi të vazhdimit.

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet.

Përvoja e punës: Së paku tri (3) vite në kontabilitet dhe auditim.

I raporton: Komisionit të Auditimit.

Koeficienti i pagës: caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Kushtet e veçanta:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të përmbushë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) t’i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (I) (iii) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet ashtu si kërkohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të jetë Auditor i Certifikuar në sektorin publik, certifikatë e cila duhet të jetë e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave, ashtu si kërkohet me nenin 22 Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjmë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.
- të ketë aftësi organizative dhe shkathtësi komunikimi.
- Njohja e programeve Microsoft Office.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përpilimi i planit të auditimit të brendshëm të ndërmarrjes konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të bazuara në legjislacion të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve investive financiare, planit vjetor dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit, deklaratat e fitimeve dhe humbjeve, si dhe deklaratave financiare.
- Vlerësimi profesional i shfrytëzimit efektiv të burimeve të ndërmarrjes dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për komisionin e auditimit, përkatësisht menaxhmentin e ndërmarrjes.
- Bën kontrollin financiar te pasurisë dhe parave te gatshme
- Udhëheqë dhe organizon auditimin e brendshëm.
- Zbaton te gjitha aktivitetet e auditimit te brendshëm.
- Kryen detyrat e përcaktuar nga Komisioni për Auditim, dhe
- Kryen edhe punët tjera të nevojshme.
- Udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A (i cili merret në zyrën e Sekretarit të ndërmarrjes);
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2. (Kjo deklaratë merret në zyrën e Sekretarit të Ndërmarrjes);
- Rezyme për jetëshkrimin e kandidatit;
- Letër Motivuese;
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (Diploma të sillet e noterizuar);
- Certifikata për Auditor të Brendshëm të lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Certifikata me të cilën dëshmohet se është ekspert në kontabilitet e lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe certifikatën nga gjykata me të cilën dëshmon se nuk është nën hetime, të dy (2) dokumentet të sillen në formë origjinale (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);.

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t’i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Intervista me gojë deri në tridhjetë (70) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në tridhjetë (30) pikë.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur katërdhjetë (40) ditë nga dita e publikimit, i hapur nga data 06.10.2025 deri me datë 14.11.2025 në ora 16:00.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Sekretarit të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Aplikimi mund të bëhet edhe nëpërmjet adresës elektronike: agron_hetemi@hotmail.com

Aplikacioni duhet të dorëzohet në një kuvertë e cila duhet të jetë e mbyllur. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 – 075 apo 044 863 819.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



U skladu sa članom 21.1 i članom 25. tačkom h) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 15.06.2008. godine, članom 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 30.05.2021. godine, kao i članom 22. Zakona br. 06/L-021 o internoj kontroli javnih finansija, objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 19.04.2018. godine, te na osnovu odluke Komisije za reviziju, protokol br. 52/25 od 29.09.2025. godine, N.P.L. "Përparimi" D.OO. dana 03.10.2025. godine donosi i objavljuje:

VANJSKI JAVNI KONKURS
(Za popunjavanje radnog mesta "Službenik interne revizije")

- I. Naslov: Službenik za internu reviziju
Broj dželata: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje termina: Radni odnos na određeno vrijeme u trajanju od tri (3) godine, sa mogućnošću produženja.
Profesionalna priprema: Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija relevantnih za sektor koji se revidira.
Radno iskustvo: Najmanje tri (3) godine iskustva u računovodstvu i reviziji.
Izveštava se: Odbor za reviziju.
Koeficijent plate: Imenuje se odlukom Upravnog odbora.

Posebni uslovi:

- Ispunjavati kriterije za službenike preduzeća u skladu sa članom 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima.
- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1, kao i kriterije nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima.
- Biti ovlašteni stručnjak za računovodstvo, u skladu sa članom 13. Zakona br. 04/L-111.
- Biti ovlašteni revizor u javnom sektoru (certifikat izdat od Ministarstva finansija) ili posjedovati certifikat internog revizora u javnom sektoru izdat od relevantne međunarodne ili domaće institucije, u skladu sa kriterijima Ministarstva finansija, kako je propisano članom 22. Zakona br. 06/L-021 o internoj kontroli javnih finansija.
- Imati dobro poznavanje važećih zakona i propisa, posebno: Zakona o javnim preduzećima i njegovih izmjena i dopuna, Zakona o privrednim društvima, Zakona o internoj kontroli javnih finansija, Zakona br. 06/L-032 o računovodstvu, finansijskom izvještavanju i reviziji, kao i drugih zakona koji se odnose na internu kontrolu i upravljanje javnim finansijama.
- Imati razvijene organizacijske i komunikacijske vještine.
- Poznavati rad na Microsoft Office programima.
- Poznavanje stranih jezika smatra se prednošću.
- Ne biti osuđivan niti protiv kandidata smije biti pokrenuta istraga.

Opis poslova i odgovornosti:

- Obavlja sastavljanje plana interne revizije preduzeća u skladu sa ciljevima, politikama i procedurama interne kontrole, na osnovu važećeg zakonodavstva.
- Vrši reviziju planova finansijskih investicija, godišnjeg plana i godišnjeg budžeta.
- Vrši reviziju godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspjeha i finansijskih izvještaja.
- Obavlja stručnu procjenu efektivnog korištenja resursa preduzeća i daje preporuke Odboru za reviziju, odnosno upravi preduzeća.
- Vrši finansijsku kontrolu imovine i gotovine.
- Organizuje, vodi i usmjerava sve aktivnosti interne revizije.
- Provodi sve aktivnosti interne revizije u skladu sa zakonom i internim aktima.
- Obavlja dužnosti koje odredi Odbor za reviziju, kao i druge zadatke u skladu sa zakonom i potrebama preduzeća.
- Za svoj rad odgovara Odboru za reviziju.

Uz prijavu je potrebno priložiti:

- Popunjen obrazac za prijavu za N.P.L. "Përparimi" Sh.A. (obrazac se može preuzeti u kancelariji sekretara preduzeća);
- Izjavu pod zakletvom, potpisanu od strane kandidata, kojom potvrđuje da ispunjava kriterije nezavisnosti iz člana 17.1 i 17.2 Zakona br. 03/L-087 (izjava se može dobiti u kancelariji sekretara preduzeća);
- Biografiju (CV);
- Motivaciono pismo;
- Ovjerenu kopiju diplome o završenim univerzitetskim studijama (ovjera kod notara);
- Važeći certifikat internog revizora izdat od strane nadležnog organa ili potvrdu o validnosti certifikata;
- Važeću potvrdu kojom se dokazuje status ovlaštenog stručnjaka za računovodstvo, izdata od strane nadležnog organa;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopiju lične karte;
- Uvjerenje suda da kandidat nije pravosnažno osuđivan, kao i uvjerenje da se protiv njega ne vodi istraga. Oba dokumenta moraju biti dostavljena u originalu i ne smiju biti starija od šest (6) mjeseci.

- Opći kriteriji koje svi kandidati moraju ispunjavati.
- Budite državljanin Republike Kosovo.
 - Da ima punu sposobnost djelovanja.
 - Da vlada barem jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Metoda ocjenjivanja kandidata.

- Usmeni intervju do trideset (70) bodova
- CV kandidata treba da ima do trideset (30) bodova.

➤ Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Dokaz o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Zdravstveni certifikat.

➤ Period za prijavu kandidata i približan kalendar postupka zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren četrdeset (40) dana od dana objavljivanja, otvorenod 06.10.2025. do 14.11.2025. u 16:00 sati.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati s kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti i predati prijavni obrazac i izjavu pod zakletvom u kancelariji sekretara Komisije za javne službe N.P.L. „Përparimi“ Sh. A., u gradu Vučitrn, ulica „Gjergj Kastriot Skënderbeu“ br. 82 (bivša zgrada KPC-a, u blizini Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu), svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Prijava se može podnijeti i putem e-mail adrese: agron_hetemi@hotmail.com. Prijava se mora dostaviti u zatvorenoj koverti. Kandidati su obavezni da tačno navedu svoju adresu, broj telefona i e-mail adresu.N.P.L. „Përparimi“ DOO u Vučitrnu obezbjeđuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za sve dodatne informacije kandidati se mogu obratiti na telefone: 044/157-075 ili 044/863-819. Napomena: Prijave podnesene nakon isteka roka neće biti razmatrane, a nepotpune prijave će se odbaciti.

➤ POJAŠNJENJE

Cilj ovog poduhvata je da se razjasni upotreba termina u smislu roda. Svi izrazi i nazivi koji su u ovom dokumentu navedeni u gramatičkom rodu (muškom ili ženskom) podrazumijevaju jednako oba roda, osim ako iz konteksta izričito ne proizlazi drugačije. Na taj način obezbjeđuje se jednak tretman svih kandidata i učesnika, bez obzira na pol ili rodnu pripadnost.

➤ ZAKLJUČAK

N.P.L. "Përparimi" DOO u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo. Posebno se podstiču da se prijave pripadnici manjinskih zajednica, osobe sa invaliditetom, kao i kandidati nedovoljno zastupljenog pola.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

TRAJNER PËR MBAJTJEN E KURSIT PËR ULTRAZËRIN DIAGNOSTIK TË
SISTEMIT OSTEOMUSKULAR

Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Përshkrim i shkurtër i qëllimit të projektit

Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e një kursi trajnues për përdorimin e ultrazërit diagnostik të sistemit osteomuskular, i dedikuar për specialistët të mjekësisë së sportit në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive. Përdorimi i ultrazërit si mjet diagnostik jo-invaziv është bërë standard në praktikën moderne të mjekësisë sportive, duke mundësuar diagnostikim të hershëm, ndjekje të progresit të lëndimeve dhe vendimarrje të shpejtë klinike.

Ky kurs do të shërbejë si trajnim me bazë teorike dhe praktike, i cili synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve shëndetësore për sportistët dhe qytetarët fizikisht aktiv që marrin shërbime në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton mjekë specialist të Radiologjisë, të interesuar dhe me eksperiencë të dëshmuar në përdorimin e ultrazërit të sistemit osteomuskular që të aplikojnë për t'u angazhuar si trajnerë në kursin e ultrazërit muskuloskeletor për mjekët e sportit.

Objektivat e angazhimit dhe rezultatet e pritura

Objektivi i këtij angazhimi të trajnerit/es është të siguroj një program trajnimi për specialistët të mjekësisë së sportit të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive në Prishtinë në fushën e ultrazërit diagnostik për sistemin osteomuskular.

Ky kurs trajnimi pritet tu ofroj specialistëve të mjekësisë së sportit në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive aftësi për të ofruar shërbime të specializuara për pacientët, dhe t'u mundësoj që të njohin më mirë dhe të jenë kompetent në kuptimin, funksionimin dhe aplikimin e ultrazërit diagnostik për sistemin osteomuskular në punën e tyre të përditshme.

Kursi pritet që të rrisë shkathtësitë diagnostike të stafit mjekësor duke siguruar përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, diagnostifikimin e shpejtë dhe vendimarrjen e duhur klinike dhe rritjen e sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Metodologjia

Trajnimi do të përbëhet nga komponenta teorike, ligjerata të përqendruara interaktive dhe komponenta praktike, trajnime në pajisje reale ultrazëri mbi modele të shëndetshme dhe pacientë me patologji të ndryshme osteomuskulare.

Pritshmëritë

Nën udhëzimin e përgjithshëm të OMK-së dhe të QKMS-ë dhe në bashkëpunim me trajnerin e angazhuar pritet të:

- Përgatiten modulet e trajnimit
- Propozohen afatet kohore të sesioneve të trajnimit

- Ngriten njohuritë mbi parimet fizike të ultrazërit dhe kontrollin e cilësisë
- Zhvillohen shkathtësitë për përdorimin e ultrazërit për diagnostifikim të patologjive më të shpeshta të sistemit osteomuskular
- Përgatitet një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve të kursit

Trajneri do të punojë drejtpërdrejt me specialistë të mjekësisë së sportit në QKMS, për të kryer me sukses detyrat e mësipërme, ai/ajo do të punojë ngushtë me menaxhmentin e QKMS dhe do të sigurojë raportin përmbledhës dhe të arriturat e trajnimit. Eksperti është i detyruar të përgatisë raportin përfundimtar të trajnimit i cili do t'i dërgohet për miratim Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Kohëzgjatja

Fillimi: Tetor 2025

Koha e parashikuar e punës: 16 ditë brenda 2 muajve

Hapi	Përshkrimi i aktivitetit	Nr. ditëve	Vendi
1	Përgatit dhe prezanton përmbajtjen e moduleve të trajnimit	1	I negociueshëm
2	Organizon dhe zbaton sesionet e trajnimit	12	I negociueshëm
3	Harton raportin përfundimtar dhe dorëzon në OMK	3	I negociueshëm
	Total	16	

Kualifikimet dhe përvoja

- Diplomë universitare në Mjekësi
- Specializim në Radiologji
- Niveli akademik paraqet përparsi
- Leje pune dhe licencë nga institucionet përkatëse profesionale
- Minimumi 8 vjet përvojë në departamentet përkatëse të specializuara;
- Të siguroj së paku një paisje të ultrazërit gjatë trajnimit, e preferueshme të jenë dy paisje të UZ
- Dëshmi për certifikata nga trajnimet e vijua në fushën përkatëse
- Aftësi të forta ndërpersonale
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit verbal dhe në të shkruar dhe përvojë e demonstruar në punën me ekepe të ndryshme
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe angleze në të shkruar dhe në të folur

Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e diplomave
- Kopja e Certifikatës së Licencimit nga institucioni përgjegjës;
- Kopja e certifikatave
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të trajnimit përkatës;
- Një letër që përfshinë ekspertizën dhe përvojën në fushën e mbajtjes së trajnimit;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozim financiar

Propozimi financiar* *Kërkesa financiare duhet të jetë e detajuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, mbajtja e trajnimit, shkrimi i raportit dhe një plan tentativë i punës;

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: info@omk-rks.org me subjektin Aplikacioni për Trajner/e për mbajtjen e trajnimit për ultrazërin diagnostik për sistemin osteomuskular apo edhe dorëzimi i aplikacionit në mënyrë fizike në zyrat e Odës së Mjekëve të Kosovës, adresa QKUK, Instituti A, Kati III, 10000, Prishtinë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 20 Tetor 2025, ora 16:00. Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.P.T. “Fatosi-Com” Adem Krasniqi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues” 810474627 me nrb: 80606524.

- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- “Fire Protection Agency Rifel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12.13.si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



100% Fresh & Natural

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

